



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA GRAMSH**  
**DREJTORIA E SHËRBIMIT PYJOR, BUJQËSISË, MBROJTJES SË KONSUMATORIT**

Nr. 1694/Prot.

Gramsh, më 12 . 05 .2021

Lënda : **Kthim përgjigje dhe dërgim informacioni.**

Drejtuar : **Znj. Aurora LEKA**

*Adresa:* Rruga “Çajupi”, Kamëz.

**TIRANË**

Për sa kërkoni në shkresën Tuaj të datës 14.04.2021 “Kërkesë për informacion”, Bashkia Gramsh ju informon si më poshtë vijon ;

Në kufinj të administrativë të Bashkisë Gramsh përfshihet vetëm një pjesë e zonës së mbrojtur “Parku Kombëtar Mali i Tomorrit”, ndërsa zonat e mbrojtura “Stravaj-Sopot” dhe “Guri i Nikës-Lenie-Valamare” nuk përfshihen në kufinj të administrativë të Bashkisë Gramsh.

Nga sipërfaqja e përgjithshme e Parkut Kombëtar “Mali i Tomorrit” prej 24106.1758 Ha (shpallur me VKM-në nr.472, date 18.07.2012), në Bashkinë Gramsh përfshihet një sipërfaqje prej 1278.9 Ha dhe pjesa tjetër në territorin e Bashkive Berat dhe Skrapar.

Lidhur me pëlqimin paraprak të Kryetarit të Bashkisë Gramsh mbi mënyrën e menaxhimit të zonës së mbrojtur “Parku Kombëtar Mali i Tomorrit”, sqarojmë se nuk është dhënë deri më sot njoftim për pëlqimin paraprak, lidhur kjo dhe me situatën jo normale të krijuar për shkak të pandemisë “COVID 19” (pasi seminarët dhe takimet janë realizuar në mënyrë elektronike) dhe Bashkia Gramsh nuk ka patur njoftim për këto takime.

Gjithashtu Bashkia Gramsh nuk disponon dokument apo qëndrim lidhur me këtë proces për kufinj të zonave të mbrojtura dhe zonimin e brendshëm të tyre, pasi nuk i është kërkuar zyrtarisht nga institucionet e tjera përgjegjëse, ku Bashkia Gramsh është si palë e tretë në këtë proces dhe zonat e mbrojtura janë nën administrim ligjor nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me strukturat përkatëse (AKZM, AdZM).

Ndërkohë ju bëjmë me dije se institucioni i Bashkisë Gramsh si dhe njësia administrative Kushovë ku shtrihet zona e mbrojtur, ka mbështetur shpalljen e Malit të Tomorrit si Park Kombëtar si dhe për Planin e Menaxhimit të tij për zhvillimin e qëndrueshëm të kësaj zone të mbrojtur.

Ky informacion dërgohet si në formë shkresore dhe në formë elektronike sipas adresës përkatëse.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

**KRYETARI**  
**Klodian TAÇE**

